



QYTETI I SHKUPIT
Shkup

Në bazë të nenit 50 paragrafi 1, pika 14 të Ligjit për vetëqeverisje lokale ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 5/02) dhe në lidhje me nenin 20-g të Ligjit për të punësuarit në sektorin publik ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 27/2014, 199/2014, 27/2016, 35/2018 dhe 198/2018 dhe "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.143/2019 dhe 14/2020) dhe nenit 11 dhe nenit 11-b të Ligjit për zjarrfikësit ("Gazeta zyrtare e RM-së" nr. 67/2004, 81/2007, 55/2013, 158/2014, 193/2015 dhe 39/2016 dhe "Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr. 152/2019), dhe në lidhje me Rregulloren për sistematizim të vendeve të punës në administratën e Qytetit të Shkupit nr.08-9664/1 të datës 10.12.2020, 08-9664 të datës 10.12.2020, 08-9664/4 të datës 15.01.2021, 08-9664/8 të datës 03.02.2021, 08-9664/11 të datës 11.02.2021, 08-9664/14 të datës 18.03.2021, 08-9664/18 të datës 23.04.2021, 08-9664/20 të datës 21.05.2021 08-9664/23 të datës 15.06.2021 dhe 08-9664/28 të datës 29.07.2021 dhe Vendimit për pranim të punëtorëve nr. 08-10895/1 të datës 02.12.2021, Qyteti i Shkupit, shpall:

KONKURS PUBLIK nr. 4/2021
për punësim të punëtorëve në Qytetin e Shkupit në kohë të pacaktuar

Përcaktohet nevoja për punësim të punëtorëve në Qytetin e Shkupit në kohë të pacaktuar të angazhimit punues në vendin vijues të punës:

1. Zjarrfikës – shpëtimtarë me shifrën POZH0210V04000 në Njësitin territorial zjarrfikës të Qytetit të Shkupit – Brigada për mbrojtje zjarrfikës e Qytetit të Shkupit (BMKZ), Sektori për mbrojtje dhe shpëtim.....**20 realizues.**

Kandidati duhet ti përmbush këto kushte vijuese:

Kushtet e përgjithshme:

- Të jetë nënshkruar në Republikën e Maqedonisë,
- Në mënyrë aktive të shfrytëzoj gjuhën maqedonase,
- Të jetë i moshës së pjekur,
- Të posedoj aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës dhe
- Me aktgjykim të plotfuqishëm të mos i jetë shqiptuar dënimi me ndalim të ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose të detyrës.

Kushtet e posaçme:

- IV sipas Kornizës maqedonase për kualifikime të kenë fituar 180 ose 240 kredi sipas ECVET ose MKSOO ose së paku arsim të lartë ose të mesëm;
- Të ketë aftësi shëndetësore dhe psiko – fizike të përcaktuar nga institucioni i autorizuar shëndetësorë në pajtim me ligj;
- Me ose pa përvojë pune në profesionin përkatës, të evidentuar në Agjencinë për punësime të Republikës së Maqedonase, si stazh pune.

Kompetenca të nevojshme për vendin e punës:

- mësim dhe zhvillim,
- komunikim,
- realizimi i rezultateve,
- puna me të tjerët / puna ekipore dhe

- orientimi drejtë palëve të cenuara.

Kandidati mund ta merr **Fletëparaqitjen për punësim sipas konkursit publik nr. 4/2021 (për Zjarrfikës shpëtimtarë)** nga ueb faqja e Qytetit të Shkupit www.skopje.gov.mk ose në Arkivin e Qytetit të Shkupit në barakën nr. 16 në adresën bul. Ilinden nr. 82, Shkup.

Kandidati është i detyruar që përveç fletëparaqitjes për punësim në lidhje me konkursin publik nr. 3/2021, t'i dorëzojë edhe dëshmitë për përmbushjen e kushteve të lartpërmendura në origjinal ose kopje të verifikuar te noteri, edhe atë:

- Dëshmi për nënshtetësinë;
- Dëshmi se me aktgjykim të plotfuqishëm të mos i jetë shqiptuar dënimi me ndalim të ushtrimit të profesionit, veprimtarisë ose të detyrës;
- Dëshmi për përfundimin e nivelit përkatës të arsimit;
- Dëshmi për aftësinë shëndetësore dhe psikofizike (për zjarrfikësit profesionist) të përcaktuar nga institucioni i autorizuar shëndetësor, në pajtim me ligjin.

Kandidati, nëse posedon përvojë pune mund të dorëzojë edhe dëshmi për përvojën e punës në profesionin përkatës, të evidentuar në Agjencinë për punësim të Republikës së Maqedonisë.

*Shuma monetare e neto pagës bazë për vendin e punës Zjarrfikës – shpëtimtarë është **22.541,00 denarë.***

Orari i punës është në ndërrime edhe atë – 12 orë punë, 24 orë pushim, 12 orë punë, 48 orë pushim.

Vërejtje: Në pajtim me Planin vjetor për punësim në Qytetin e Shkupit për vitin 2021, në konkursin e shpallur për vendin e punës zjarrfikës – shpëtimtarë – 20 realizues, duhet të punësohen 14 (maqedonas / maqedonase), 4 (shqiptarë / shqiptare), 1 (turk/e) dhe 1 (serb / serbe).

Kandidatët e interesuar, dokumentet e kërkuara duhet ti dorëzojnë në arkivin e Qytetit të Shkupit (baraka nr. 16) ose në adresën bul. Ilinden nr. 82, Shkup me emërtimin – për **KONKURSION PUBLIK nr. 4/2021 për punësim të punëtorëve në Qytetin e Shkupit në kohë të pa caktuar – për vendin e punës me numrin rendor nr. 1**.

Afati për paraqitje është 5 ditë pune nga dita e shpalljes së konkursit. Kushtet e theksuara në konkursin, kandidatët duhet t'i përmbushin në çastin e parashtrimit të fletëparaqitjes.

Vërejtje: Nëse kandidati në fletëparaqitjen e tij nuk ka dorëzuar të dhënat për kontakt (numrin e telefonit ose e – mail adresë), fletëparaqitja e tij do të refuzohet.

Informacion për mënyrën e realizimit të procedurës për përzgjedhjen e kandidatëve për punësim:

Faza 1: kontrollimi i fletëparaqitjes dhe dëshmitë – realizohet në afatin prej 8 ditëve pas përfundimit të konkursit të shpallur. Nëse mungon ndonjë dëshmi, Komisioni për përzgjedhje do ta kontaktoj kandidatin përmes adresës së tij elektronike ose përmes numrit të telefonit të shënuar në fletëparaqitje dhe në afatin prej tre ditëve ai duhet t'i kompletojë dëshmitë, në të kundërtën fletëparaqitja do të refuzohet. Fletëparaqitja do të refuzohet edhe nëse dëshmia / dëshmitë janë të rreme.

Faza 2: kontrollimi i aftësive fizike të kandidatëve nga ana e Komisionit për përzgjedhje të formuar nga ana e Kryetarit të Qytetit të Shkupit.

Faza 3: intervista me kandidatët e përzgjedhur – realizohet në afatin prej 10 ditëve pas realizimit të fazës së dytë të përzgjedhjes.

Fazat e procedurës së përzgjedhjes, në mënyrë të detajuar janë të përcaktuara në Rregulloren për kriteret për përzgjedhjen e kandidatëve për punësim në Njësitin territorial zjarrfikës të Qytetit të

Shkupit – Brigada për mbrojtje zjarrfikëse, e cila është shpallur në ueb – faqen e Qytetit të Shkupit (www.skopje.gov.mk).

Vërejtje: Kandidati i përzgjedhur në pajtim me këtë konkurs, është i obliguar që në afatin prej një viti nga dita e punësimit, të siguroj certifikatën për kualifikimin për zjarrfikës, të dhënë nga institucioni i autorizuar nga Ministria për arsim dhe shkencë, në të kundërtën do ti pezullohet punësimi.

QYTETI I SHKUPIT